



KOMUNA E LIPJANIT

RAPORT

- Projekt rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit

RAPORT

- Projekt rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit

Nga procesverbali për konsultimin publik për projekt rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit, mbajtur më 07.06.2021, në platformën online zoom.

Në mbledhje prezantuan: 1.Bukurie Zejnullahu - Jashari Të tjerë prezent:

1.Bukurie Zejnullahu –Jashari

2.Besart Troshupa

3.Qendresa Jashanica 4.Vlora Krasniqi

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Besart Troshupa

Kryesuesi i takimit, përmes platformës online zoom pasi që janë kyçur persona të ndryshme në këtë takim, së pari është konstatuar se mund të vazhdoj takimi duke testuar zërin dhe detaje të tjera, ku më pastaj kryesuesi i këtij takimi ka prezantuar projekt rregulloren për transparencën në Komunën e Lipjanit.

Gjatë këtij takimi po ashtu, është bërë edhe prezantimi i rregullores përmes sllajdeve ku është mundësuar edhe të shohin rregulloren, gjithashtu të pranishmit në këtë takim online kanë patur mundësi që të bëjnë pyetje.

Në fund të këtij takimi kryesuesi i këtij takimi ka kërkuar nga të pranishmit që të bëjnë ndonjë pyetje apo ndonjë paqartësi në lidhje me temën, kështu pasi që nuk janë paraqitur ndonjë pyetje, ka mbyllur këtë takim.

Të kyçur në platformën ZOOM ishin 43 persona.



Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik së bashku me linkun për kyçje në këtë takim është bërë 7 ditë para se të mbahej takimi gjithashtu, pas takimit është bërë edhe lajm që është postuar në ëeb faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit.

Shtesë: Foto nga takimi online përmes platformës ZOOM

Shtesë: Linku lajmit të publikuar në web faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/mbahet-diskutim-publik-lidhur-me-projektrregulloren-per-transparence/>